



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 9668 Prot.

Vlorë, më 20. 06. 2024

PROJEKT - VENDIM

Nr. ____, datë. ____ . ____ . 2024

PËR

**NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ETIKËS,
STANDARDEVE DHE APELIMEVE, NË KËSHILLIN E BASHKISË VLORE**

Bazuar në nenin 8, nenin 9/1 pika 1.1/d, nenin 54 germa "a", nenin 55 pika 2, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; në nenin 4, pika 5 të Ligjit nr. Nr.9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri"; në nenet 29, 30 dhe 31 të Rregullores së Keshillit të Bashkisë Vlorë, miratuar me Vendim nr. 35, datë 28.03.2022 të Këshillit të Bashkisë; në nenin 7 të Rregullores "Kodi i sjelljes dhe të parandalimit të konfliktit të interesave të Këshilltarit Bashkiak", miratuar me Vendim nr 31, datë 31.04.2020 të Keshillit të Bashkisë", si dhe në relacionin bashkëlidhur,

Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës 27.06.2024,

VENDOSI:

1. Të miratoje krijimin e "Komisionit të Etikës, Standardeve dhe Apelimit" të Keshillit të Bashkisë Vlorë me 7 anëtarë nga të cilët 4 anëtarë nga Këshilltarët e shumicës dhe 3 anëtarë nga pakica e Këshillit të Bashkisë.
2. Të miratojë si anëtarë të Komisionit të Etikës, Standardeve dhe Apelimit këshilltarët:
 1. Roland Strakosha
 2. Ilir Aliaj
 3. Aurora Qarri
 4. Brikena Sika
 5. Simo Petromilo
 6. Geron Gunbardhi
 7. -
3. Kryetar i Komisionit miratohet Z. Roland Strakosha.
4. Nënkyetar i Komisionit miratohet Z. -.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni i Etikës, Standardeve dhe Apelimit të Këshillit të Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 55 pika 6

KRYETAR

Elpinqi Mërkuri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 9668 Prot.

Vlorë, më 20.06. 2024

RELACION

**MBI PROJEKT-VENDIMIN “PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E
KOMISIONIT TË ETIKËS, STANDARDEVE DHE APELIMEVE” NË
KESHILLIN E BASHKISË VLORË**

Para Këshillit të Bashkisë Vlorë

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Bashkisë,

Projektvendimi që po ju paraqesim për miratim lidhet me krijimin e Komisionit të Etikës, Standarteve dhe Apelimeve në Këshillin e Bashkisë i cili është i domosdoshëm në funksion të procedurave disiplinore që mund të iniciohen në Këshillin e Bashkisë si dhe shqyrtimin e rasteve të konfliktit të interesave për Këshilltarët.

Sikurse jeni në dijeni, Këshilli i Bashkisë Vlorë me Vendim nr. 31, datë 02.04.2020 ka miratuar Rregulloren "Kodi i sjelljes dhe të parandalimit të konfliktit të interesave të keshilltarit bashkiak", e cila është e publikuar edhe në faqen zyrtare të Bashkisë Vlorë.

Në nenin 7 të kesaj rregulloreje parashikohet ngritja dhe funksionimi i Komisionit të Etikës, Standardeve dhe Apelitimit në Këshillin e Bashkisë Vlorë.

Ky komision ka objekt të punës respektimin e parimeve të parashikuara në nenin 3 të Rregullores, mbikeqyrjen e funksionimit të Këshillit Bashkiak, permbushjen e detyrimeve nga anëtarët e Këshillit të Bashkisë sipas dispozitave të nenit 5 të rregullores, raportimin e thyerjeve të Kodit të Etikës, evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit/pengesës ligjore nga ana e keshilltarit bashkiak, si dhe dhenien e masave disiplinore të keshilltareve në raste të shkeljeve disiplinore, sipas parashikimeve të nenit 12 të Rregullores së sipërcituar.

Me qëllim permbushjen e detyrimit që buron nga neni 7 i Rregullores të sipërcituar, si dhe bazuar në nenin 8, nenin 9/1 pika 1.1/d, nenin 54 germa "a", nenin 55 pika 2, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore "; në nenet 29, 30 dhe 31 të Rregullores

së Keshillit të Bashkisë Vlorë, miratuar me Vendim nr. 35, datë 28.03.2022 të Keshillit të Bashkisë, i propozoj Keshillit të Bashkisë të miratojë projektvendimin:

Për ngritjen dhe funksionimin e "Komisionit të Etikës, Standardeve dhe Apelimeve" në Këshillin e Bashkisë Vlorë.

Komisioni i Etikës, Standardeve dhe Apelimit sipercituar propozohet të perbehet nga 7 anëtarë, nga grupet politike të shumices dhe pakices në Keshill.

Në zbatim të Ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazine gjinore në shoqeri", Komisioni i Etikës, Standardeve dhe Apelimit që propozohet në projekt-vendimin e sipercituar parashikohen që në përberje të tij duhet të respektojë barazinë gjinore.

Emrat e këshilltarëve të propozuar për anëtarë të këtij Komisioni sipas projektvendimit janë përcaktuar në konsultim me grupet politike të këshilltarëve që përfaqësojnë Këshillin e Bashkisë dhe referuar kriterëve të përfaqësimit pozit-opozit në Këshill si dhe në respekt të parimit të barazisë gjinore.

Nga sa parashtruam më lartë, duke votuar projekt-vendimin për "Ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Etikës, Standardeve dhe Apelimit", plotesojme detyrimin që rrjedh nga aktet ligjore e nenligjore të cituara me lart, por i shërben edhe ndjekjes me korrektesë nga Këshilli i Bashkisë të vendimmarrjes në rastet e procedurave disiplinore.

Theksoje së, menyra e funksionimit të Komisionit është parashkuar në rregulloren perkatese, të miratuar gjithashtu edhe nga Këshilli i Bashkisë.

Ju faleminderit.

KRYETAR

Elpiniqi Merkurji

